



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 170 Akti

Nr. 153 Vendimi
Tiranë, më 7.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 6 qershor 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ened Nakuçi**, me detyrë prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417”, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. **Subjekti i rivlerësimit**, z. Ened Nakuçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. ***, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.9.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues komisionere Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit

të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa nr. *** prot., datë 9.7.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 1.3.2019), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi.*

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 19.4.2019.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, në datën 24.5.2019, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 24.5.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 27.5.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 3.6.2019.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 5.6.2019, vendosi të ftojë subjektin, z. Ened Nakuçi, në këtë seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 3.6.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 6.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Subjekti i rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Ened Nakuçi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit z. Ened Nakuçi, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- nuk ka mosdeklarime të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, me nr. indeksi ***, datë 22.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

❖ **Apartament** me sip. 136 m², Rr. “****”, Tiranë, i paregjistruar.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- Të ardhurat nga paga nga projekti për periudhën 2000 – 2003 në shumën 1,425,600 lekë, si dhe kursimet e prindërve.
- Në vitin 2004 janë paguar 2 këste nga 10,000 USD secili. Burimi: të ardhura nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së subjektit; vlera 2,500 USD hua nga prindërit e bashkëshortes; vlera 2,500 USD hua nga motra, I.P., si dhe 5,000 USD hua nga xhaxhai i subjektit, z. V.N.
- Në vitin 2005 është paguar shuma prej 15,000 USD, burimi nga pagat vjetore dhe 500,000 lekë nga prindërit.

- Në vitin 2006 është paguar shuma 6,900 USD nga të ardhurat e pagës së subjektit dhe të bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit, se kjo pasuri nuk është e regjistruar, përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Gjatë fazës së hetimit të kryer nga Komisioni është konstatuar se në datën 4.9.2003, subjekti ka lidhur kontratë porosie pranë noterit D. P. (kontrata me nr. *** rep.) me shoqërinë “****” për ndërtimin e një apartamenti 3+1 me sip.143 m², Rr. “****”, Tiranë. Sipas kontratës mënyra e pagesës për blerjen e kësaj pasurie do të ishte: pagesë prej 19,305 USD në datën 23.9.2003; pagesë prej 20,040 USD me mbarimin e karabinasë; pagesë prej 25,045 USD një muaj para marrjes së çelësave.

Shoqëria “****” në datën 22.11.2013, ka deklaruar me anë të vërtetimit nr. *** prot., se nga ana e subjektit të rivlerësimit kjo pasuri e paluajtshme është likuiduar plotësisht dhe se z. Ened Nakuçi nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj shoqërisë.

Për këtë qëllim vetë subjekti ka paraqitur si provë dhe mandatarkëtimet për shlyerjen e detyrimeve kontraktore të lëshuara nga shoqëria “****”, si më poshtë:

- mandatarkëtimin e datës 2.8.2004 në vlerën 10,000 USD;
- mandatarkëtimin e datës 3.11.2004 në vlerën 10,000 USD;
- mandatarkëtimin e datës 19.5.2006 në vlerën 2,900 USD.

Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e plotë për blerjen e kësaj pasurie, por vetëm vlerën e shlyerjes së saj për vitin 2003 në shumën prej 19,305 USD, me shoqërinë “****”. Burimi i pagimit të kësaj shume për vitin 2003 kanë qenë të ardhura personale të subjektit dhe ato familjare, si dhe të ardhurat e fituara nga subjekti për projektin Fellowship i “****”, për vitet 1999 – 2002, në shumën rreth 1,400,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i të ardhurave për shlyerjen e detyrimit në vitin 2004, për këtë pasuri kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Ndërkohë burime të tjera për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2004 janë deklaruar:

- vlera 2,500 USD hua nga prindërit e bashkëshortes;
- vlera 2,500 USD hua nga motra e subjektit, znj.I. P;
- vlera 5,000 USD hua nga xhaxhai i subjektit, z. V.N.

Në vitin 2005 është paguar shuma prej 15,000 USD me burim të ardhurat nga pagat vjetore të subjektit dhe të bashkëshortes, si dhe shuma prej 500,000 lekësh nga të ardhurat e prindërve të subjektit.

Në vitin 2006 është paguar dhe shuma prej 6,900 USD, si burim nga të ardhurat e pagës së subjektit dhe të bashkëshortes së tij.

Gjatë fazës hetimore të kryer nga Komisioni nuk rezultoi dokumentacion shkresor provues lëshuar në periudhën përkatëse (vitin 2004) për marrjen huas nga motra dhe xhaxhai i subjektit, si dhe nga prindërit e bashkëshortes së tij.

Lidhur me huan e marrë nga xhaxhai i subjektit ka paraqitur një deklaratë noteriale, datë 14.10.2016, ku deklarohet se z. V.N., i ka dhënë subjektit shumën prej 5,000 USD, në vitin 2004 dhe se kjo shumë i është kthyer plotësisht xhaxhait në vitin 2008.

Lidhur me gjetjet e bëra nga Komisioni mbi këtë pasuri është pyetur subjekti dhe në rezultatet e hetimit iu kërkuan shpjegime dhe iu kalua barra e provës lidhur me konstatimet si më poshtë:

- *Komisioni konstatoi se në deklaratën e fillimit të detyrës në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën totale të kësaj pasurie, por vlerën prej 19,305 USD, e cila përkon me vlerën e paguar nga subjekti ndaj shoqërisë për vitin 2003.*
- *Në deklaratat periodike për vitet 2005 – 2007 subjekti nuk ka deklaruar detyrimet financiare që kishte ndaj personave përkatës, si dhe në deklaratën periodike për vitin 2008 nuk ka deklaruar kthimin e plotë të këtyre huave. Nuk disponohet dokumentacion ligjor provues shkresor për marrjen e huave nga ana e subjektit në vitin 2004, si dhe nuk vërtetohet dhe dokumentohet kalimi i shumës prej 1,400,000 lekësh nga fondacioni në llogarinë e subjektit.*
- *Gjithashtu, nuk është paraqitur dokumentacion provues i plotë lidhur me mundësitë financiare të subjekteve huadhënës, sidomos të xhaxhait, z. V.N. Subjekti ka deklaruar se xhaxhai ka pasur të ardhura nga puna në SHBA, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues për dokumentimin e burimit të ligjshëm dhe mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se xhaxhai i tij ka pasur dhe ka përfituar edhe pension në Shqipëri, por nuk është paraqitur dokumentacion provues lidhur me menaxhimin e këtij pensioni nga babai i subjektit, si dhe kalimin e shumës së huas në emrin e subjektit.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

“Në lidhje me mënyrën e deklarimit të vlerës së pasurisë, si dhe detyrimeve që kisha ndaj personave juridikë dhe fizikë në vitet përkatëse, sqaroj se në vitin 2003, në përpilimin e deklaratës së parë të pasurisë, kam kuptuar se duhej të deklarohej vetëm vlera e paguar deri në atë moment.

Në vitet në vazhdim, 2004, 2005, 2006, kam deklaruar vlerat e kësteve/detyrimeve të paguara të apartamentit. Prej meje nuk ishte kuptuar drejt që deklarata e këtyre pagesave duhej të shoqërohej me deklarimin e detyrimit mbetës. Gjithsesi kontrata e sipërmarrjes së këtij apartamenti ka qenë e depozituar në ILDKPKI dhe në këtë kontratë pasqyrohej çmimi i apartamentit. Gjithashtu, vlera e apartamentit është deklaruar e plotë në deklaratën “Vetting”.

Për sa i përket huave të marra nga motra, xhaxhai dhe vjehrra, ato janë deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2004. Lidhur me mungesën e një dokumenti provues për huan, siç kam shpjeguar në përgjigjet e dorëzuara në datën 21.2.2019, bazuar në Kodin Civil, në pjesën e posaçme për kontratën e huas, nuk përcaktohet detyrimi për formalizimin e kontratës. Këto hua janë marrë nga persona mjaft të afërt të rrethit tim familjar dhe për rrjedhojë në nuk kemi hartuar ndonjë dokument zyrtar për formalizimin e kësaj marrëdhënie huaje, në momentin e marrjes së huas apo edhe të shlyerjes së saj. Këto hua janë marrë dhe janë kthyer në cash.

Për shlyerjen e huave, në vitin 2008, ashtu siç kam deklaruar në datën 8.3.2016 në ILDKPKI, burimi i të ardhurave për shlyerjen e tyre kanë qenë kursimet tona familjare nga momenti i marrjes së huas dhe deri në momentin e shlyerjes së tyre.

Unë nuk e kam deklaruar shlyerjen e këtyre detyrimeve në vitin 2008, për shkak të të kuptuarit në mënyrë jo të saktë të pasqyrimin të shlyerjes së këtyre detyrimeve në formularin e deklaratës. Perceptimi im ka qenë që në rast se huaja është shlyer, nuk duhet deklaruar më si detyrim, dhe për këtë arsye nuk kam dhënë asnjë shpjegim në deklaratë.

Ashtu siç kam deklaruar në procesverbalin e datës 8.3.2016, të mbajtur në ILDKPKI, gjatë një procesi kontrolli të pasurisë, pyetjes në lidhje me mospasqyrimin e shlyerjeve i jam përgjigjur si vijon: “Shlyerjet e huave janë kryer në vitin 2008, kam menduar se duke e lënë rubrikën e detyrimeve të paplotësuar nënkuptohej që nuk kam më detyrime ndaj të tretëve”.

*Për të provuar shlyerjen e këtyre huave, po ju paraqes deklaratën noteriale të motrës sime, znj. I.P., nr. ***, datë 29.5.2019 dhe të vjehrrës Y.M., nr. ***, datë 29.5.2019.*

Lidhur me dokumentacionin provues për menaxhimin e pensionit të xhaxhait dhe mundësitë financiare të xhaxhait, sqaroj se ky i fundit ka shkuar me SHBA që prej vitit 1996, me programin e llotarisë amerikane. Që prej largimit, ai i ka kërkuar babait tim të kujdesej për shtëpinë e banimit duke e autorizuar dhe dhënien e saj me qira. Gjithashtu, në momentin e mbushjes së moshës për pensionin e parakohshëm si ish-ushtarak, ai i ka dhënë babit tim tagrat me prokuroria të ndryshme për tërheqjen e pensionit.

Ndërkohë, xhaxhai ka qenë i punësuar në SHBA nga viti 1996 e deri në vitin 2016, ku ka dalë në pension. Në vitin 2018 ai është rikthyer në Shqipëri. Xhaxhai në SHBA ka qenë me familjen dhe familjarët e tjerë, të cilët ishin madhorë dhe të punësuar, duke realizuar të ardhura të mjaftueshme dhe për këtë arsye nuk kishin nevojë që të ardhurat nga pensioni apo dhe qiratë t'i tërhiqnin në SHBA.

Lidhur sa më lart, për këtë qëllim po ju paraqes aktet që disponoj:

Prokurën e posaçme e kam paraqitur para jush si argument që provon faktin që babai im jo vetëm që ka menaxhuar tërheqjen e pensionit të xhaxhait, por ka pasur tagrin edhe për të kryer veprime juridike për vëllanë e tij, z. V.N, dhe kjo ka ndodhur që nga momenti i largimit të këtij të fundit për në SHBA.

Pavarësisht dokumentacionit që po ju paraqes bashkëlidhur, ripërsëris qëndrimin tim se shuma prej 5,000 USD dhënë hua nga xhaxhai, ka qenë tërësisht e bazuar në vlerat e pensioneve të tërhequra nga babai im, z. N.N”.

Arsyetimi ligjor

Lidhur me mundësitë financiare të subjektit u provua sipas analizës financiare se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare dhe burime të ligjshme për kryerjen e pagesave të deklaruar nga ana e tij për blerjen e kësaj pasurie në vitet respektivë 2003, 2004 dhe 2005. Të ardhurat e subjektit të vërtetuara nga institucionet përkatëse ku ka punuar për këto vite, mbulojnë shumat e paguara prej tij për blerjen e kësaj pasurie. Të ardhurat e subjektit nga marrëdhëniet e punës për periudhën 1998 – 2003, si dhe të ardhurat e përfituara nga fondacioni “***”, kanë qenë në total në shumën 4,131,209 lekë.

Lidhur me të ardhurat e prindërve, subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me të ardhurat nga pensionet për periudhën 1987 – 2005, si dhe gjendjen e likuiditeteve bankare. Gjithashtu, ka rezultuar se në vitin 2004 babai i subjektit ka pasur llogari bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën prej 683,100 lekësh. Nga kjo shumë rezulton e tërhequr në datën 13.6.2005, vlera prej 500,000 lekësh, vlerë e cila sipas subjektit ka qenë kontributi i prindërve për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti.

Lidhur me shumat e huave të marra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm marrjen e huas në vitin 2004 nga motra e tij dhe nga prindërit e bashkëshortes. Këto hua të marra janë deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2004 nga subjekti, por nuk janë deklaruar nga ai si detyrime në deklaratat periodike për vitet 2005 – 2008, si dhe as kthimi më pas i tyre në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008.

Subjekti i rivlerësimit nuk provoi dhe nuk dokumentoi me prova shkresore ekzistencën e veprimit juridik për marrjen e këtyre huave para plotësimit të deklaratës “Vetting”.

Neni D, “Vlerësimi i pasurive” i Aneksit të Kushtetutës përcakton se subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet deklaramit dhe kontrollit të pasurive me qëllim identifikimin e pasurive në pronësi ose në përdorim, saktësimin e burimit të ligjshëm të pasurive, përfshirë dhe ato pasuri të cilat nuk i kanë deklaruar saktësisht ndër vite. Pra, subjekti i rivlerësimit kishte mundësinë që të kryente veprime juridike para plotësimit të deklaratës “Vetting”, lidhur me vërtetimin e veprimeve për marrjen e huave dhe për sigurimin e burimit të ligjshëm të tyre.

Në lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa, sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur, deklaramet e interesave privatë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni. Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni.

Deklarata e pasurisë së rivlerësimit duhet të ketë të njëjtën përmbajtje me deklaramet periodike të pasurisë, me ndryshimin se në këtë deklaratë subjekti duhet të bëjë një pasqyrim të saktë të të gjitha pasurive të akumuluar në vite. Kontrolli dhe krahasimi i deklarameve të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë është i domosdoshëm pasi u shërben organeve të rivlerësimit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarameve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e deklarameve të tij apo ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite, si dhe të burimeve të krijimit të pasurisë.

Në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, vlerësimi i deklarameve të mëparshme është i rëndësishëm, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin, më pas, që deklaratën e pasurisë së rivlerësimit duhet ta plotësojë me saktësi të plotë. Ligji nr. 84/2016 synon realizimin e kontrollit të pasurisë së deklaruar në deklaramet periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit, si një kontroll të bazuar në deklaramet në vazhdimësi të subjekteve të rivlerësimit.

Nëse deklarata e pasurisë së rivlerësimit është hartuar me saktësi dhe me vërtetësi, por në deklaramet e mëparshme në lidhje me të njëjtën pasuri subjekti ka paraqitur deklarime të pasakta ose mosdeklarime, këto deklarime ose mosdeklarime të shkuara shërbejnë si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Për këtë arsye, deklaramet periodike të pasurisë, u njihet vlera e provës sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, provat janë të dhëna që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces. Në këtë kuptim, ligji nr. 84/2016, duke u dhënë deklaramet të mëparshme të pasurisë vlerën e provës i ka çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Në këtë aspekt, lidhur me huan e marrë nga xhaxhai, z. V.N., subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e xhaxhait nga pensioni në Shqipëri, si dhe të ardhura nga puna e tij në SHBA. Sipas të dhënave të dërguara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2019, rezultoi se xhaxhai i subjektit, z. V.N., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 5,000 euro. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 19.2.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezulton se të ardhurat e pensionit të z. V. N., në vitet 1996 – 2004, kanë qenë në vlerën 676.183 lekë, të barasvlershme me 7.149 USD. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për t'i huazuar shumën prej 5.000 USD subjektit të rivlerësimit në vitin 2004.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë dhe prokurat e posaçme të lëshuara në vitet 2000, 2002 dhe 2003, ku provohet se përfaqësues dhe administrues i të ardhurave të xhaxhait të tij, z. V.N., është babai i subjektit, z. N.N. Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, të datës 30.12.2003, xhaxhai i subjektit ka lëshuar prokurë të posaçme ku emëron babanë e subjektit për tërheqjen e pensionit suplementar për një periudhë 1-vjeçare: dhjetor 2003 – nëntor 2004, e cila përkon me periudhën e deklaruar nga subjekti për marrjen e huas nga të ardhurat e xhaxhait. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, lidhur me provueshmërinë e marrjes së huas nga xhaxhai, ka paraqitur edhe deklaratën noteriale të përpiluar pranë noterit publik në datën 14.10.2016, pra, para datës së dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI.

Pra, për sa më sipër, Komisioni bazuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, deklaratën “Vetting” të muajit janar 2017 dhe deklaratën noteriale të datës 14.10.2016, arriti në përfundimin se deklarimet e subjektit lidhur me marrjen e huas nga xhaxhai janë bindëse, si dhe gjatë fazës hetimore është provuar edhe mundësia financiare e xhaxhait për këtë huadhënie.

Por, nuk mund të thuhet e njëjta gjë dhe për marrjen e huas nga motra e subjektit dhe prindërit e bashkëshortes së subjektit, pasi në analizimin e fakteve, të provave dhe të deklaratave subjekti nuk arriti të provonte kryerjen e veprimeve juridike për marrjen e këtyre huave në vitin 2004, deklarimin e huave në deklaratat periodike 2005 – 2008, si dhe shlyerjen e tyre më pas në vitin 2008. Këtë fakt subjekti nuk e provoi dhe nuk e vërtetoi as me veprime juridike të kryera përpara dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

Në përfundim konstatohet se:

Në analizën financiare është përfshirë nga Komisioni vetëm huaja e marrë nga xhaxhai i subjektit, z. V.N., në vitin 2004 dhe kthimin më pas në vitin 2008. Huaja e marrë nga motra dhe prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk janë përfshirë në analizën financiare për shkak se subjekti nuk arriti të paraqesë prova shkresore për të provuar bindshëm për kryerjen e veprimeve juridike për marrjen e huave në vitin 2004 dhe kthimin më pas të tyre.

- ❖ **Bashkëpronar në apartamentin me sip. 73 m²**, me nr. pasurie ***, përfituar me kontratën e datës 8.11.2010.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 92.4 m², ku subjekti ka banuar me prindërit; të ardhurat nga paga dhe kursimet e subjektit dhe të prindërve; diferenca është plotësuar me huan prej 17,000 eurosh marrë z. G.P., e cila është likuiduar plotësisht pas marrjes së kredisë në “Bankën e Parë të Investimeve”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Fibank”, nga ZVRPP-ja Tiranë dhe nga DPPP-ja.

Sipas deklarimit të subjektit kuota e bashkëpronësisë për këtë pasuri të paluajtshme është caktuar me marrëveshje dhe me dëshirën e prindërve, ku pjesa takuese e subjektit është caktuar 60 %, por nuk rezulton ndonjë akt shkresor për caktimin e tij si përfitues dhe bashkëpronar në pjesën prej 60 % të kësaj pasurie.

Gjatë fazës së hetimit rezultoi se në datën 8.11.2010, subjekti së bashku me prindërit e tij, ka blerë një apartament me sip. 73.2 m², bazuar në çmimin e referencës prej 140,000 lekë/m² dhe në vlerën totale të pasurisë prej 10,248,000 lekësh. Mënyra e pagesës është bërë e menjëhershme *cash* në dorë jashtë zyrës noteriale.

Në datën 16.6.2010, rezultoi se subjekti dhe prindërit e tij kanë shitur apartament me sip. 92.4 m², në vlerën 6,375,600 lekë, ndodhur në Rr. “****”, Tiranë.

Në datën 8.10.2010 me anë të kontratës së huas nr. ***, të lidhur pranë noterit, subjekti ka marrë hua nga shtetasi G.P., shumë prej 17,000 eurosh. Kjo shumë sipas kontratës së huas është përdorur për blerjen e apartamentit nga subjekti, shumë të cilën më pas subjekti ia ka shlyer huadhënësit me miratimin e kredisë në datën 21.12.2010 nga “Fibank”. Me shkresën e datës 5.2.2019 të “FiBank” është konfirmuar se në datën 12.1.2011 është *disbursuar* kredia në vlerën prej 17.000 eurosh. Në të njëjtën datë rezultoi se është shlyer dhe detyrimi ndaj huadhënësit G.P., nëpërmjet veprimeve bankare.

Lidhur me këtë pasuri është pyetur subjekti, i cili ka kthyer përgjigje, duke deklaruar:

“Për blerjen e kësaj pasurie kam marrë kredi në “Fibank” në shumën 17,000 euro. Meqenëse banka kërkonte garanci hipotekore u detyrova që në datën 8.11.2010 të merrja hua afatshkurtër të daja i bashkëshortes G.P., të cilën e përdora për shlyerjen e vlerës së plotë për blerjen e apartamentit. Menjëherë pas hipotekimit të këtij apartamenti përfunduam procedurën e marrjes së kredisë. Kredia u finalizua në datën 21.12.2010 dhe shuma e kredisë u përdor nga ana ime për shlyerjen e huas ndaj, z. G.P. Bashkëlidhur transfertën bankare për kthimin e shumës nga “Fibank” te G.P.

*Për blerjen e këtij apartamenti kemi kontribuar: 31,700 euro nga prindërit, ku 26,100 euro janë të ardhura nga shitja e shtëpisë së ndodhur në Rr. “****”(datë 10.11.2010) dhe 5,600 euro paguar cash (datë 10.11.2010); 25,100 euro nga subjekti si burim shitja e shtëpisë në Rr. “****”(datë 10.11.2010); 17,000 euro kredi te “Fibank” (datë 18.11.2010).*

Për pagesat e kryera cash nga z. G.P., dhe prindërit nuk disponoj dokumentacion. Nga shitja e pasurisë së mëparshme janë paguar të gjitha detyrimet në ZVRPP-në dhe paraqes mandatin përkatës. Me shtetasin G.P., nuk kam pasur asnjë çështje në asnjë periudhë”.

Komisioni konstatoi mospërputhje të deklarimeve pasi në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 subjekti kishte deklaruar se ka paguar një pjesë të vlerës prej 4,500 eurosh nga të ardhurat e tij, të cilat disponoheshin si gjendje në bankë.

Rezultoi se llogaria bankare e tërhequr nga subjekti ka qenë në shumën prej 4,000 eurosh dhe jo në shumën prej 4,500 eurosh.

Gjithashtu në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se diferenca tjetër prej 5,600 eurosh, për blerjen e kësaj pasurie është paguar nga babai i tij, por pa deklaruar burimin e ligjshëm. Komisioni konstatoi se subjekti nuk kishte provuar dhe nuk kishte dokumentuar burimin e ligjshëm të vlerës 5,600 euro për blerjen e kësaj pasurie.

Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat shkresore në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

*“Për sa i përket mosekzistencës së ndonjë akti shkresor për marrëveshjen e caktimit tim si përfitues i pjesës prej 60 % të apartamentin me sip. 73 m², sqaroj se ndarja në këto raporte është dakordësuar mes nesh me marrëveshje verbale në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe ky fakt është pasqyruar në hyrjen e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 8.11.2010, ku në rubrikën blerësit janë cituar dhe përqindja në masën e pasurisë.*

*Ky fakt gjendet i pasqyruar dhe në aktet e regjistrimit të kësaj prone në ZVRPP-në Tiranë (shiko kopje kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 8.11.2010 dhe të kartelën e pasurisë, dorëzuar bashkëlidhur dhe deklaratës “Vetting”).*

Konfirmoj se shuma prej 4,500 eurosh e paguar nga ana ime për këtë pasuri ka si burim të ardhurat e mia familjare, të cilat disponoheshin në llogaritë tona bankare dhe respektivisht

- *Shuma 4,000 euro siç është evidentuar nga ana juaj disponohej në llogarinë bankare në euro ndërsa pjesa tjetër (shihni pikën tjetër);*
- *Shuma ekuivalente për 500 euro disponohej në llogarinë bankare në lekë, të cilat janë tërhequr nga ana ime dhe janë konvertuar në euro për këtë qëllim.*

Të ardhurat e prindërve të mi kanë si burim kursimet e tyre të krijuara ndër vite nga të ardhurat nga pensionet, si dhe të ardhura të tjera në shuma të vogla e të herë pas herëshme të dhëna nga vëllai i tij, z. V.N., që jetonte në SHBA. Ndërkohë ne kemi jetuar se së bashku me prindërit dhe shpenzimet e tyre jetësore kanë qenë minimale, madje në periudha të caktuara pensionet e tyre nuk kanë qenë kontribuuese në të ardhurat e familjes. Siç është evidentuar nga ana juaj, në të gjitha vitet paraardhës se unë kam rezultuar me një tepricë pozitive të konsiderueshme. Këto teprica kanë shërbyer si burim për të përballuar dhe shpenzimet vjetore”.

Arsyetimi ligjor

Lidhur me mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie Komisioni konstatoi se subjekti e ka blerë këtë pasuri bazuar në vlerat financiare si më poshtë:

- Vlera prej 26,100 eurosh (rreth 3,623,202 lekë) pagesë nga babai i subjektit me burim shitjen e shtëpisë së ndodhur në Rr: “****”,***, Tiranë.

Komisioni konstatoi se kjo shumë prej 26,100 eurosh, korrespondon me shumën e përfituar nga babai i subjektit, si e ardhur e krijuar nga shitja e pasurisë apartament.

- Vlera prej 25,100 eurosh (rreth 3,484,382 lekë) pagesë nga subjekti i rivlerësimit me burim shitjen e shtëpisë së ndodhur në Rr. “****” dhe diferenca nga kursimet personale.

Komisioni konstatoi se kjo shumë prej 25,100 eurosh, korrespondon me shumën e përfituar nga subjekti si e ardhur e krijuar nga shitja e apartamentit, dhe pjesa tjetër e mbetur prej 4,500 eurosh është përballuar nga tërheqja e llogarive bankare në emër të subjektit. Rezultoi se subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij në euro në “ProCredit Bank” shumën prej 4,000 eurosh

në datën 28.9.2010, shumë e cila ka shërbyer për likuidimin e një kësti, për blerjen e apartamentit në fjalë.

- Vlera prej 17,000 eurosh marrë hua nga shtetasi G.P., dhe shlyerjen e kësaj huaje brenda vitit, bazuar në kredinë bankare të marrë në “Fibank”.

Komisioni konstatoi se në vitin 2010 subjekti ka marrë hua nga shtetasi G.P. Marrja e huas u provua me dokumentacionin shkresor provues të vitit 2010: deklarata noteriale e vitit 2010; deklarata periodike vjetore e vitit 2010; si dhe veprimet bankare të kryera për marrjen e kredisë dhe shlyerjen e plotë të saj shtetasit G.P., Komisioni vlerësoi, gjithashtu, edhe burimet e ligjshme dhe mundësitë financiare të huadhënësit G.P. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.8.2007, kontratën nr. ***, datë 27.10.2008, kontratën nr. ***, datë 19.4.2008, si dhe në deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.4.2008, rezultoi se huadhënësi G.P., ka pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas prej 17.000 eurosh.

- Vlera prej 5,600 eurosh pagesë nga të ardhurat e babait të subjektit.

Komisioni konstatoi se të ardhurat e prindërve të subjektit nga pensionet për periudhën 1987 – 2010 kanë qenë në shumën totale prej 4,943,756 lekësh. Duke zbritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në shumën prej 2,785,044 lekësh rezultoi se prindërit e subjektit dispononin mundësi financiare për kontributin e tyre në vlerën 5,600 euro.

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë këtë pasuri të paluajtshme, si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e saj.

❖ **Automjet, tip “Ford Kuga”**, me targa AA *** LG, blerë në datën 19.2.2015, në shumën prej 26,300 eurosh.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura në vlerën 8,900 euro nga shitja e automjetit tip “Skoda” në vitin 2014, shtuar kësaj diferenca deri në shumën 13,800 euro, e cila është mbuluar nga llogaria e përbashkët me bashkëshorten; shuma prej 2,500 euro nga gjendja *cash*; si dhe shuma 10,000 euro kredi në “ProCredit Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja, nga “ProCredit Bank” dhe nga DPPPP-ja.

Rezultoi se në datën 19.2.2015, subjekti ka lidhur kontratë më shoqërinë “****” për blerjen e një automjeti tip “Ford Kuga” në vlerën 26,300 euro. Pagesa në vlerën 16,300 euro do të kryhej nga subjekti menjëherë dhe pjesa tjetër prej 10,000 eurosh do të likuidohej, më pas, para dorëzimit të mjetit. Në dosjen e administruar nga Komisioni rezultoi një faturë për kryerje veprimi në “Credins Bank” në datën 19.2.2015 nga shtetasi E.B., për llogari të subjektit në shumën prej 2,500 eurosh. Gjithashtu, në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton veprim i kryer nga subjekti për tërheqje depozite në vlerën prej 13,800 eurosh.

Kjo tërheqje e depozitave është bërë në datën 20.2.2015, pra, një ditë pas lidhjes së kontratës ku përcaktohej pagesa prej 16,300 eurosh. Në datën 23.2.2015 është lëshuar certifikata e pronësisë së këtij automjeti në emrin e subjektit. Sipas vërtetimit të “Intesa Sanpaolo Bank” shuma prej 7,500 eurosh është kaluar në llogarinë e shitësit dhe diferenca është deklaruar si

pagesë *cash* nga subjekti. Në datën 25.2.2015 rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë kredie konsumatore për vlerën 10,000 euro.

Me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 24.7.2014, rezulton se subjekti ka shitur në vlerën prej 8,900 eurosh, automjetin tip “Skoda”, të cilin e ka pasur në pronësi.

Mbi gjetjet e Komisionit, lidhur me mospërputhjen e datave për kryerjen e veprimeve për këtë pasuri, është pyetur subjekti, i cili ka deklaruar: *“Procedura kërkonte që përpara marrjes së kredisë duhej që automjeti të regjistrohej në pronësinë time. Shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e shitësit në datat 26 dhe 27 shkurt 2015. Dorëzimi i mjetit është bërë në datën 26 shkurt 2015. Pagesa prej 2,500 eurosh është bërë cash nga z. E.B., si menaxheri i kompanisë “Ford”. Këto të ardhura janë të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes, të cilat i dispononim cash. Për këtë paraqes dokumentacionin justifikues bashkëlidhur”.*

Arsyetimi ligjor

Veprimet e subjektit për blerjen e kësaj pasurie janë pasqyruar saktë nga ai në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike vjetore. Burimet e ligjshme financiare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie janë deklaruar saktë nga subjekti dhe Komisioni nuk konstatoi parregullsi. Shtetasi E.B., i cili ka kryer veprime në “Credins Bank” në emër të subjektit, rezultoi se ishte punonjës i shoqërisë shitëse të mjetit. Veprimet financiare të kryera dhe shlyerja e kredisë për blerjen e kësaj pasurie janë pasqyruar në analizën financiare.

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë këtë pasuri të paluajtshme, si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e saj.

- ❖ **Llogari në “Credins Bank”** në vlerën 1,332 USD. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga pjesëmarrja në trajnime.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Bazuar në vërtetimin e “Credins Bank” rezultoi se subjekti disponon llogari bankare në vlerën 1,332.46 USD.

Është konstatuar se kjo llogari bankare është llogari e krijuar nga të ardhurat e ligjshme të subjektit lidhur me trajnimet e kryera në kuadrin e detyrave të tij funksionale si prokuror.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni bazuar dhe në analizën financiare konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë lidhur me këtë llogari bankare.

- ❖ **Llogari e përbashkët** me bashkëshorten në emrin e subjektit, z. Ened Nakuçi, në vlerën 2,979 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat personale të subjektit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Bazuar në vërtetimin e bankës “Intesa Sanpaolo Bank” është konstatuar se subjekti ka llogari bankare në këtë bankë në vlerën 2,979.89 euro. Kjo llogari është krijuar nga subjekti dhe në të janë përfshirë të ardhurat e përfituara dhe të deklaruara nga ai dhe nga bashkëshortja ndër vite.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni bazuar dhe në analizën financiare konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë lidhur me këtë llogari bankare.

- ❖ **Llogari kursimi** në emër të djalit, N.N., në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 1,160,920 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat personale të subjektit dhe bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Sipas vërtetimi të “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se subjekti ka llogari bankare në vlerën 1,160,920.18 lekë. Këtë llogari bankare dhe ndryshimet e saj ndër vite subjekti i ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni bazuar dhe në analizën financiare konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë lidhur me këtë llogari bankare.

- ❖ **Llogari kursimi** në euro, në emër të vajzës së subjektit, N.N., në “Intesa Sanpaolo Bank”. Vlera: 8,276 euro.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Veting”: të ardhurat personale të subjektit dhe të bashkëshortes. Në deklaratën “Vetting” në rubrikën “Konfidenciale” është deklaruar nga subjekti se burimi i një pjese të kësaj kredie janë edhe të ardhurat e shtetasve rumunë M., dhe M.A.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Sipas vërtetimi të “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se likuiditeti për këtë llogari bankare është në vlerën 8,276.64 USD. Këtë llogari bankare dhe ndryshimet e saj ndër vite subjekti i ka deklaruar dhe në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

Arsyetimi ligjor

Si burimi krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat personale të tij dhe të bashkëshortes. Ndërkohë ka deklaruar dhe të ardhura nga shtetasit rumunë M., dhe M.A. Lidhur me kontributin e këtyre shtetasve Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë, duke e verifikuar me veprimet e kryera bankare dhe me deklaratat periodike vjetore, se këto shtetas janë kumbarët e vajzës së subjektit, N.N. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit nga këta shtetas të huaj për kontributin e dhënë, iu kërkua subjektit të paraqiste dokumentacion dhe prova shkresore. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të provuar burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni, bazuar në përgjigje të pyetësorit, në provat e vëna në dispozicion nga subjekti dhe në analizën financiare, konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë lidhur me këtë llogari bankare dhe se kjo pasuri është krijuar nga burime të ligjshme.

❖ Gjendje *cash* në vlerën 1,200,000 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: krijuar nga të ardhurat në vite të subjektit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për akumulimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” gjendje *cash* në vlerën 1,200,000 lekë. Në deklaratat periodike vjetore për vitin 2016 dhe 2017, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar.

Trajtimi i mundësisë për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* është bërë nga Komisioni bazuar në analizën financiare.

Për këtë gjendje *cash* të disponuar jashtë sistemit bankar, si dhe për gjetjet e Komisionit, është pyetur subjekti, i cili ka deklaruar: *“Në deklaratën periodike të vitit 2015 kam deklaruar kursime në vlerën 500,000 lekë. Është e vërtetë që në deklaratën periodike për vitin 2016 kam harruar të deklaroj gjendjen cash, por meqenëse e kisha deklaruar në deklaratën “Vetting”, gabimisht kam harruar ta deklaroj dhe në deklaratën periodike. Vlera prej 1,200,000 lekësh, është rezultat i tepricave të deklaruara në vitet 2014 dhe 2015 në vlerën 1,200,000 lekë dhe 500,000 lekë. Duke qenë se në vitin 2017 kam shpenzuar për blerje garazhi dhe udhëtime vlera e mbetur cash ka qenë shumë e vogël dhe nuk e kam deklaruar në deklaratën për vitin 2017”*.

Arsyetimi ligjor

Rezultoi se në deklaratën periodike për vitin 2016, subjekti i rivlerësimi nuk ka deklaruar gjendjen *cash*, si detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Ky mosdeklarim i subjektit në deklaratën periodike vjetore, nuk sjell pasoja për t’u penalizuar nga Komisioni, për shkak se subjekti ka deklaruar në deklaratat e mëparshme periodike gjendjen *cash* të krijuar si dhe në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni bazuar dhe në analizën financiare konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj gjendje *cash* në deklaratën periodike për vitin 2016, Komisioni arriti në përfundimin se ka qenë një harresë e subjektit, e cila nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar të bërë nga Komisioni për këtë likuiditet, pasi është deklaruar në deklaratën “Vetting”.

❖ Apartament, Rr. “*” nr. pasurie ***, zk. ***, Tiranë, ku vlera sipas vlerësimit është 9,360,000 lekë. Pjesa takuese e bashkëshortes: 25 %.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në dosje rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 10.7.2001 ku bashkëpronare rezultoi dhe bashkëshortja e subjektit.

Kjo pasuri rezultoi se është krijuar para lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten e tij, por nuk është deklaruar si pasuri nga ana e tij dhe e bashkëshortes në deklaratat periodike vjetore që nga viti 2003. Kjo pasuri është deklaruar nga ana e subjektit vetëm në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016.

Për këtë pasuri është pyetur subjekti, i cili ka deklaruar: *“Jam martuar në vitin 2004 dhe që nga ky moment nuk kam qenë në dijeni se prindërit e bashkëshortes e kishin bërë atë pjesëtare në momentin e privatizimit të apartamentit. Në periudhën e privatizimit bashkëshortja ka qenë nën moshën 18 vjeç. Në momentin e përpilimit të deklaratës “Vetting” dhe rivlerësimit të kësaj pasurie, jam vënë në dijeni se bashkëshortja është bashkëpronare e kësaj pasurie në kuotën prej 25 %. Kjo pasuri nuk ka shërbyer dhe nuk shërben si burim të ardhurash”.*

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes të tij në deklaratat periodike vjetore 2003 – 2016 . Nisur nga fakti se kjo pasuri është përfituar nga bashkëshortja e subjektit para lidhjes së martesës dhe se kjo pasuri nuk ka shërbyer si burim të ardhurash, Komisioni arriti në përfundimin se mosdeklarimet periodike vjetore nuk mund të penalizojnë subjektin pasi këtë pasuri që ka në bashkëpronësi bashkëshortja e tij e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Analiza financiare, për periudhën 2003 - 2018

	I	II	III	IV = (II-III)	V	VI = I - IV - V
VITI	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
2003	1,558,104	4,754,111	4,554,111	200,000	187,928	1,170,176
2004	1,985,130	0	-1,418,700	1,418,700	421,306	145,124
2005	2,380,822	91,798	-1,549,950	1,641,748	419,351	319,723
2006	2,679,746	-86,897	-646,337	559,440	1,275,878	844,428
2007	2,804,312	1,882,125	858,938	1,023,187	1,055,782	725,342
2008	2,552,133	44,523	-991,277	1,035,799	1,085,559	430,775
2009	2,143,256	116,644	-377,190	493,834	1,162,328	487,094
2010	3,143,570	4,030,262	2,359,770	1,670,492	1,377,950	95,128
2011	2,261,684	491,437	-168,578	660,016	1,226,780	374,888
2012	2,770,957	862,715	-174,492	1,037,207	1,572,795	160,955

2013	3,095,724	664,434	-778,806	1,443,240	1,430,792	221,692
2014	4,384,756	1,112,287	-264,963	1,377,251	1,453,046	1,554,459
2015	3,772,755	2,405,809	40,062	2,365,748	1,457,566	-50,559
2016	3,130,199	780,237	-444,605	1,224,843	1,301,552	603,805
2017	2,488,012	-661,490	-470,090	-191,400	2,312,520	366,891
2018	2,841,748	-787,173	-77,298	-709,875	2,684,536	867,086
TOTAL	43,992,908	15,700,825	450,594	15,250,232	20,425,668	

Në përfundim konstatohet se:

Bazuar në analizën financiare Komisioni konstatoi se subjekti ka pamundësi burimesh financiare vetëm për vitin 2015 në shumën -50,559 lekë. Kjo pamjaftueshmëri burimesh financiare nuk rezulton problematike nga Komisioni për të penalizuar subjektin e rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

B. NË LIDHJE ME KONTROLLIN E FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 1.3.2019, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi”*. Ky raport është i deklasifikuar plotësisht.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të përshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

C. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit Ened Nakuçi është përgatitur nga KLP-ja, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në përshkrimin dhe analizimin:

- 1) e formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti;
- 2) e pesë dosjeve/praktika penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) e të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar dhe relatori i çështjes, i cili ka paraqitur përpara trupës së Komisionit, relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Ened Nakuçi.

PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

DOSJA NR. 1

Në datën 4.10.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. *** ndaj shtetasve E.T., A.B., A.S., dhe Sh. K., për veprën penale të trafikimit të narkotikëve parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Në datën 24.10.2014, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit pasuror, në kuadër të procedimit penal nr. ***, mbështetur në nenet 2, 3, 6 dhe 24, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se janë respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe me referenca ligjore materiale. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Fashikulli paraqitet i plotë dhe, nga pikëpamja e formës dhe e renditjes së akteve procedurale, pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Rezultoi se kjo çështje dhe veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë zgjatur 4 vjet dhe 20 ditë, në tejkalim të afateve të përcaktuara nga Kodi Procedurës Penale.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Sqaroj se në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, që është ligji i zbatueshëm në atë kohë për këtë dosje, para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70 të vitit 2017, në pikat 1 dhe 2, të nenit 5 të tij, ku rregullohet “Marrëdhënia me procedimin penal”, thuhet se:

“1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.”

Pra, për hetimin pasuror në bazë të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe të trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nuk parashikohen afate për kryerjen e hetimit pasuror.”

Sqarime të tjera për këtë çështje subjekti i ka dhënë në përgjigje të rezultateve të hetimit¹.

DOSJA NR. 2

Dokumenti ligjor: “Vendim për pushimin e procedimit penal”, nr. ***, datë 17.5.2013

Procedimi penal nr. ***, me datë regjistrimi 17.5.2013, i Prokurorisë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, regjistruar për veprën penale “prodhim dhe shitje e

¹ Shihni përgjigjet e rezultateve të hetimit të subjektit në dosjen e Komisionit.

narkotikëve”, në bashkëpunim, “trafikim i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2, 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Në këtë veprimtari kriminale dyshohet të jenë të përfshirë shtetasit: K.B., lindur dhe banues në ***, ***, A.R. (A.), lindur në ***, ***, dhe banues në ***, M. (M.) A., lindur dhe banues në ***, si dhe B.Zh., lindur dhe banues në ***. Pas regjistrimit të procedimit penal, me qëllim identifikimin e autorëve të përfshirë në veprimtarinë kriminale, janë kryer disa veprime hetimore.

Në rrethanat e lartpërmendura, prokurori Ened Nakuçi, pasi ka vlerësuar se janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, nga të cilat nuk rezultuan të dhëna që tregojnë për aktivitet kriminal të shtetasve A.R., K. B., B.Zh., A.J., S.Xh., A. R., në mbështetje të gurmës “a”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, në datën 2.4.2014, ka vendosur:

- 1. pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2013, pasi nuk ekzistojnë të dhëna për ekzistencën e veprës penale;*
- 2. bashkë me pushimin të kërkohet dhe asgjësimi i CD-ve, i procesverbaleve të transkriptimit dhe i regjistrimeve të bëra në serverin e Sektorit të Përgjimit të Telekomunikacioneve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.*

Nga aktet e fashikullit nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Komisioni thekson se në vendimin nr. ***, datë 18.1.2017, vendim ky përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese, citohet se:

“54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”.

Komisioni është i mendimit se në çështjen nr. 2 të caktuar me short dhe në procedimin penal nr. *** janë bërë gabime thelbësore dhe serioze nga subjekti gjatë kryerjes së funksioneve si prokuror i çështjes.

Nga analiza e të gjithë praktikës (dosjes) në dispozicion, pavarësisht nga informacioni i saktë, i detajuar dhe i besueshëm i departamentit të antinarkotikëve dhe trafiqeve në Drejtorinë Rajonale të Policisë Vlorë, pasi subjekti ka siguruar dhe emrat e individëve (pra: K.B., A.R., M.A., B.Zh., S.Xh., A.R., A.J., E.S., B.R.) të dyshuar si të përfshirë në krimet e parashikuara nga neni 283/a/2 aplikuar së bashku me nenin 22 të Kodit Penal (“trafikimi i narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, në formën e “veprës së mbetur në tentativë”), numrat e tyre të telefonit, të dhënat nga TIMS-i dhe fotot, si dhe rekordet e tyre kriminale të përditësuara, ka regjistruar procedimin pa emra (ndaj personave të panjohur), në kundërshtim me nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe as në përputhje me dispozitat e nenit 293/1 dhe 295/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Kjo sjellje neglizhente vërehet/konfirmohet edhe më tej nga fakti se vendimi i subjektit i datës 2 prill 2014, i cili është marrë në bazë të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale (me titull “pushimi i akuzës ose çështjes”), përfshin gjithashtu edhe emrat e individëve, numrat e telefonave të cilëve janë përgjuar, pra, ai si prokuror ka pasur dijeni.

Për më tepër, nga përmbajtja e dokumenteve në dispozicion, duket se nuk janë kryer përgjime ndaj dy individëve (E.S., dhe B.R.), të cilët janë përmendur në informacionin e paraqitur nga sektori i antinarkotikëve dhe nuk është e mundur të kuptohet pse është zgjedhur një pistë/rrugë e tillë e ndryshme hetimore nga subjekti.

Përveç kësaj, në vendimin e subjektit të datës 2 prill 2014, i cili çoi në mbylljen e procedimit /hetimeve, thuhet se nuk vërtetohet se personat (të cilët janë përgjuar) të jenë përfshirë në veprimet e dyshuara kriminale, në një situatë të tillë:

a) është kryer vetëm përgjimi (dhe jo ndaj të gjithë personave të adresuar nga agjencia antinarkotik);

b) duket se disa nga personat që mund të konsideroheshin si të dyshuar kanë pasur precedentë kriminal të së njëjtës natyrë kohët e fundit;

c) disa nga personat që mund të konsideroheshin të dyshuar ishin përpjekur të ndryshonin numrat e tyre të telefonit;

ç) nuk rezulton asnjë përpjekje / veprim i bërë nga subjekti, si prokuror i çështjes - për verifikimin e informacionit që lidhet me rezultatin e veprimeve hetimore të përgjimit, siç pranohet nga policia gjyqësore (që çoi në pushimin e akuzave);

d) për më tepër, në dosjen e disponueshme nuk ka dëshmi të veprimeve “të drejtimit dhe të mbikëqyrjes” nga subjekti ndaj zyrtarëve të policisë gjyqësore, siç parashihet me nenin 233/1 të Kodit të Procedurës Penale;

dh) Ky konkluzion është konfirmuar nga dokumenti i datës 25 mars 2014 dhe është nënshkruar nga oficerët e policisë gjyqësore E.L., dhe I.M., duke deklaruar se kanë qenë në kontakt me dy specialistë nga zyra kombëtare e përgjimit në Tiranë dhe se nuk ka pasur komunikim të interesave ose të dyshimtë; ky dokument, i quajtur “informacion”, sugjeroi pushimin e akuzave, që më vonë u miratua nga subjekti më 2 prill 2014, pa asnjë kontroll të mëparshëm mbi përmbajtjen e CD-ve dhe të dokumenteve të tjera (transkriptimet eventuale të përgjimeve dhe raportet shtesë), të cilat mund të ishin bërë.

Në përfundim, Komisioni është i mendimit se sjellja dhe veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes, në përputhje me rrethanat e saj, është një sjellje neglizhente si rezultat i gabimeve thelbësore dhe serioze në aspektin hetimor dhe investigues, duke çuar në një përfundim jo të saktë për vlerësimin e aftësive profesionale.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Lidhur nga sa pretendohet në raport, vlen të sqarohet natyra e regjistrimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2013, i cili ka qenë një procedim proaktiv. Procedimi penal i mësipërm ka qenë në përputhje të plotë me praktikën e ndjekur nga kjo prokurori ndër vite, ku fillimisht regjistrohet procedimi penal dhe pas kryerjes së veprimeve hetimore, kur rezultojnë të dhëna apo prova për implikim të personave në kryerjen e veprës penale, procedohet me regjistrimin e emrit të personit të cilit

i atribuohet vepra penale me një urdhër të veçantë. Urdhri për regjistrimin e emrit të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në rastet e procedimeve proaktive gjithmonë nga prokurorët e krimeve të rënda është bërë me një urdhër të ndryshëm nga urdhri për regjistrimin e procedimit penal.

Kjo praktikë është në përputhje me ligjin procedural penal dhe është ndjekur nga Prokuroria për Krime të Rënda, për arsye se brenda tre muajve nga momenti i regjistrimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale referuar nenit 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori duhet të përpilojë një vendim për zgjatjen e afatit hetimor, të cilin duhet t'ia njoftojë personit ndaj të cilit zhvillohen hetime ose mbrojtësit të tij. Nëse do të bëhej regjistrimi i emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale ose personit nën hetim do të bëhej dhe zgjatja e afatit, kjo do të sillte për pasojë shkatërrimin e hetimeve proaktive të filluara, pasi personi do të merrte dijeni për hetimet që kryheshin ndaj tij dhe do të dekonspirohej hetimi paraprak.”

Sqarime të tjera për këtë çështje subjekti i ka dhënë në përgjigje të rezultateve të hetimit.²

DOSJA NR. 3

Dokumenti ligjor: “Vendim për pushimin e procedimit penal”, nr. ***, datë 20.9.2015

Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë regjistrimi 20.9.2015, regjistruar për veprën penale “korrupsion aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar respektivisht nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e akteve të referuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, nga Drejtoria e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, si dhe nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar Tiranë. Pas regjistrimit të procedimit penal, me vendimin datë 20.9.2015, prokurori ka lejuar përgjimin e komunikimeve telefonike të shtetasve të identifikuar si të dyshuar.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore subjekti i rivlerësimit, prokurori Ened Nakuçi, në mbështetje të germës “a”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, në datën 5.4.2016, ka vendosur:

- *Pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2015, pasi nuk provohet se fakti ekziston.*
- *Të njoftojë me këtë vendim personat e interesuar.*

Nga aktet e fashikullit nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Nga përmbajtja e aktit konstatohet se janë respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimin dhe fjalitë janë të qarta. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti është i qartë dhe vendimi logjik. Në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit Penal, si dhe të Kodit të Procedurës Penale ku mbështetet vendimi.

² Shihni përgjigjet e rezultateve të hetimit të dërguar nga subjekti në dosjen e Komisionit.

DOSJA NR. 4

Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë regjistrimi 25.12.2012, regjistruar për veprën penale “trafikim i lëndëve narkotike”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Nga aktet rezultojnë se në datën 25.12.2012, në pikën e kalimit kufitar Durrës, pas një kontrolli të ushtruar në automjetin tip “Renault” me targa AA *** DO, është gjetur një sasi e dyshuar si lëndë narkotike me peshë rreth 26 kg, fshehur në kroskotin e automjetit dhe në serbatorin e makinës. Në automjet ndodheshin shtetasit A.S., dhe M.M., të cilët janë arrestuar në flagrancë si persona të dyshuar për trafikimin e lëndëve narkotike.

Prokurori Ened Nakuçi, në datën 12.11.2013, ka marrë vendim për njoftimin e akuzës dhe pas njohjes me akuzën dhe me të gjitha materialet e çështjes nga ana e të pandehurve, në datën 15.11.2013, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale, mbështetur në nenin 331, të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të gjyqimit të çështjes penale, zhvilluar me gjykim të shkurtuar, në ngarkim të të pandehurve, në mbështetje të nenit 378/1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.1.2014, ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit A.S., për veprën penale “trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 283/a dhe nga neni 22 i Kodit Penal dhe bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij përfundimtar me 6 vjet burgim.*
- *Deklarimin fajtor të së pandehurës M.M., për veprën penale “trafikim narkotikësh” parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 283/a, nga neni 22 i Kodit Penal dhe bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e saj përfundimtar me 5 vjet e 4 muaj burgim.*
- *Asgjësimin e lëndës narkotike të sekuestruar.*
- *Në bazë të nenit 36 të Kodit Penal, konfiskimin e mjetit më targa AA *** DO së bashku me dokumentacionin.*

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.3.2014, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 14.7.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të të gjykuarve A.S., dhe M.M.

DOSJA NR. 5

Procedimi pasuror nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë regjistrimi 16.4.2015

Nga aktet rezultojnë se në bazë të informacioneve të mbledhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, shtetasit E.B., (i njohur dhe me gjeneralitetet B.B., dhe E.M.), lindur në Vlorë, dhe shtetasi I.K., (I.B.), lindur në Vlorë, kanë kryer investime në fushën e ndërtimit, si dhe transaksione me shumica të konsiderueshme, të cilat dyshohen se janë produkt i aktivitetit kriminal të ushtruar prej tyre. Konkretisht, nga të dhënat e deritanishme ka rezultuar se shtetasi

E.B., (B.) dhe i ndjeri vëllai i tij, I.K., (i cili ka gjetur vdekjen në gusht të vitit 2014) kanë ndërtuar një godinë 5-katëshe në lagjen “****”, Vlorë, me destinacion resort turistik.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.4.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e pasurive:

- *objekti truall, parcelë ndërtimore me sip. 2500 m², z.k. ***, lagja “****”, Vlorë, me pronar shtetasin Sh. B.;*
- *objekti ndërtësë pesëkatësh me sip. 3089 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, lagja “****”, Vlorë, në emër të shtetasit Sh. B.*

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.9.2018, ka vendosur:

- *lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.5.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.*

Të dhënat nga burimet arkivore

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe nga burimet në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezulton që subjekti Ened Nakuçi të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer për vitet 2014, 2015 dhe 2016, si dhe ka vlerësimin “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm.

I. Në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 4.11.2016, për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal. Kallëzuesja M.V., ka parashtruar para oficerëve të policisë gjyqësore se në datën 27.10.2016, rreth orës 16:00, ka qenë duke udhëtuar me automjetin e saj me targa AA *** IB, në Rr. “****”, Tiranë, kur është goditur nga një automjet tjetër me targa AA *** LG, që drejtohej nga shtetasi Ened Nakuçi. Kallëzuesja ka shpjeguar se drejtuesi i mjetit me targa AA *** LG është larguar ndërsa ajo vetë nuk ka lëvizur nga vendi i aksidentit. Shtetasi Ened Nakuçi ka shpjeguar se mjeti me targa AA *** IB i ka prerë rrugën dhe ka menduar se dëmtimin të parafangoja e ka pasur që më parë. Megjithatë, ai, pasi ka marrë vajzën në kopsht, është rikthyer te vendi i përplasjes dhe nuk e ka gjetur drejtuesen e mjetit tjetër. Më pas e ka parë në lëvizje dhe ka lajmëruar një punonjës të policisë rrugore për të sqaruar rastin. Prokurori i çështjes, pas verifikimeve paraprake, ka konkluduar se shtetasi Ened Nakuçi është rikthyer në vendngjarje dhe ka njoftuar policinë rrugore për aksidentin. Ai nuk ka kryer asnjë veprim me qëllim shmangien nga përgjegjësia ligjore për ngjarjen automobilistike, duke konkluduar se fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në datën 1.12.2016 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***, bazuar në nenet 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i mosfillimit u është njoftuar palëve.

Lidhur me denoncimin nr. ***, të datës 4.11.2016 dhe lidhur me aksidentin që ka ndodhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe znj. M.V., Komisioni dëshiron të theksojë që në nenin 187, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 (të Kodit Rrugor) – i vitit 2016 – i ndryshuar – thuhet si vijon:

Neni 187 - Mënyra e veprimit në rast aksidenti

“1. Përdoruesi i rrugës, në rast aksidenti, që në njëfarë mënyre lidhet me sjelljen e tij, është i detyruar të ndalojë dhe t’u japë ndihmën e nevojshme njerëzve të dëmtuar. Përdoruesi i rrugës është i detyruar të njoftojë shërbimet e emergjencës mjekësore dhe të Policisë Rrugore.

2. Njerëzit e përfshirë në një aksident duhet të zbatojnë të gjitha masat e përshtatshme për të ruajtur sigurinë e qarkullimit dhe të veprojnë duke ruajtur gjendjen e vendit të aksidentit, si dhe gjurmët e tij, të nevojshme për përcaktimin e përgjegjësisë, por gjithmonë duke garantuar sigurinë e qarkullimit.

3. Shfuqizuar.

4. Aty ku si pasojë e aksidentit janë shkaktuar vetëm dëme në materiale, drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë në aksident, duhet, gjithashtu, të shmangin pengimin e qarkullimit, aty ku është e mundur, sipas dispozitave të nenit 159. Punonjësit e shërbimit të policisë rrugore, në raste të tilla, duhet të bëjnë zhvendosjen e menjëhershme të çdo pengese për qarkullimin, përveç kryerjes me shpejtësi të madhe të vëzhgimeve të mundshme për të qartësuar aksidentin.

5. Në çdo rast, drejtuesit e mjetit duhet, gjithashtu, t’i japin emrin dhe adresën, si dhe informacione të tjera të nevojshme, edhe për qëllim dëmshpërblimi, njerëzve të dëmtuar ose, në qoftë se këta nuk janë të pranishëm, t’ua komunikojnë atyre me mënyra të ndryshme elementet e sipërtreguara.

6. Për cilindo që në kushtet e treguara në pikën 1 të këtij neni nuk zbaton detyrimin e ndalimit në rast aksidenti, vetëm me dëme materiale, zbatohet masa administrative, me gjobë, nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë dhe me pezullimin e lejedrejtimit nga 6 deri në 12 muaj.

7. Cilido që, në kushtet e treguara në pikën 1, në rast aksidenti me dëme në njerëz, nuk zbaton detyrimin e ndalimit, dënohet sipas Kodit Penal. Zbatohet edhe masa administrative plotësuese e pezullimit të lejedrejtimit për një periudhë nga një deri në dy vjet.

8. Cilido që, në kushtet e treguara në pikën 1, nuk zbaton detyrimin e dhënies së ndihmës së nevojshme njerëzve të plagosur, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.

9. Shfuqizuar.

10. Cilido, që nuk zbaton dispozitat e pikave 2, 4 dhe 5 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë”.

Paragrafi 6 i këtij neni përcakton qartë detyrimet e shoferit të një automjeti në rast aksidenti ku shkaktohen vetëm dëme materiale. Masat administrative zbatohen pa marrë parasysh përgjegjësinë eventuale penale që mund të lindin për shkelje të nenit 273³ të Kodit Penal.

Ndonëse është për t’u lëvdur kujdesi që tregon babai për të marrë nga kopshti, nëse subjekti do ta zbatonte siç duhej dispozitën, duhej të kishte ndaluar në momentin e përplasjes, që të

³ Neni 273 i kodit penal: *Largimi nga vendi i aksidentit.*

[1] *“Largimi nga vendi i aksidentit, i drejtuesit të automjetit apo të çdo mjeti të motorizuar, për t’u shmangur nga përgjegjësia penale, civile apo administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”*

verifikohej se çfarë kishte ndodhur dhe të kryente veprimet e mëtejshme në mënyrën e duhur. Kjo radhë veprimesh ka rëndësi të veçantë, pasi subjekti është magjistrat dhe sjellja e tij jashtë vendit të punës, mënyra që perceptohet nga Komisioni llogaritet si çështje e sjelljes etike dhe e besimit të publikut, çka është e sigurt se ka pasoja në vlerësimin profesional të subjektit.

Faktikisht, çështja e etikës nuk vlen vetëm për përmbushjen e detyrave si prokuror. Ajo mbulon edhe sjelljen në jetën private dhe veprimtarinë jashtë detyrave profesionale. Përveç respektimit të ligjit dhe bindjes ndaj tij si të gjithë shtetasit e tjerë, nga magjistratët pritet edhe të silleni me integritet dhe ndershmëri, të jenë të rezervuar dhe të kujdesshëm, si gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, ashtu edhe në jetën private.

Për sa i përket parimit të integritetit, ai i referohet edhe korrektesës, dinjitetit dhe nderit që duhet të ketë jeta private dhe ajo sociale e një magjistrati. Nuk është e lehtë të përcaktohet saktësisht përmbajtja e saktë e këtyre parimeve dhe as që ekziston ndonjë përcaktim shterues, megjithë listat me shembuj që mund të ekzistojnë. Në raste të tilla rekomandohet të aplikohet testimi i personit të arsyeshëm, të paanshëm dhe të informuar, çka do të thotë të testohet: “...se si do të perceptohej një sjellje e caktuar nga anëtarë të arsyeshëm, të paanshëm dhe të informuar të komunitetit dhe nëse një perceptim i tillë ka gjasa të pakësojë respektin për gjyqtarin apo për gjyqësorin në tërësi”.^[2]

Komisioni krijoi bindjen se, në rastin konkret, sjellja e subjektit nuk ka qenë në përputhje me detyrat e tij në lidhje dhe me etikën. Komisioni çmoi se sipas perceptimit të anëtarëve të arsyeshëm, të paanshëm dhe të informuar të komunitetit, mosrespektimi i urdhërimeve të nenit 187 të Kodit të Qarkullimit Rrugor mbart në vetvete rrezikun e pakësimit të respektit për një magjistrat dhe/ose të gjithë gjyqësorin në tërësi. Për këtë subjekt iu kërkuan shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar: “Në rastin konkret për shkeljen e evidentuar në pikën 6 të nenit 187, së cilës i referohet Komisioni, nuk zbatohet pasi pika 1 e të njëjtit nen flet për ngjarje të cilat kanë të bëjnë me persona të dëmtuar, për të cilët është e nevojshme ndihma mjekësore dhe njoftimi i policisë rrugore. Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë të dëmtuar dhe, siç rezulton nga aktet, kam qenë unë që kam njoftuar policinë rrugore.

Pavarësisht kësaj, nga studimi i akteve të këtij kallëzimi penal rezulton se policia gjyqësore që në informacionin për referimin e veprës penale ka konstatuar se kallëzimi nuk përputhej me realitetin dhe, për këtë arsye, nuk kanë referuar ndonjë vepër penale, por kanë shkruar që po dërgojmë materialin për vlerësim. Po në referimin e policisë citojmë: “Nga veprimet e kryera nga autoriteti i qarkullimit rrugor është dokumentuar fakti se... Ened Nakuçi nuk është larguar nga vendi i aksidentit, siç pretendon M.V.”.

Lidhur me këtë ngjarje po jap shpjegime të mëtejshme,⁴ por vlerësoj se i kam bërë të gjitha veprimet sipas ligjit dhe duke ruajtur etikën për detyrën që unë mbaj”.

^[2] Shihni në Komentarin mbi Parimet e Bangalorit për Sjelljen Gjyqësore, që disponohet në www.unodc.org/pdf/corruption/corruption_judicial_res_e.pdf, pika 102. Disa dispozita të Parimeve të Bangalorit për Sjelljen Gjyqësore – që konsiderohet si Magna Charta e etikës gjyqësore në rang botëror – miratuar në vitin 2002 (që disponohen në faqen www.unodc.org), mund të zbatohen për prokurorët, duke bërë ndryshimet e nevojshme për të ruajtur analogjitë (sipas parimit *mutatis mutandis*).

⁴ Shihni përgjigjet e rezultateve të hetimit të dërguara në subjektin.

II. Komisioni, bazuar në një raport të përgatitur kohët e fundit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda në lidhje me mënyrën se si është trajtuar çështja nga prokuroria në rastin e të pandehurit z. E.Sh., (dhe të tjerëve), ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë prokuror i kësaj çështjeje që në fillim të gjyqimit. Në përfundim të gjyqimit dhe përpara seancës përfundimtare për paraqitjen e konkluzioneve për këtë çështje, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë pjesë, duke braktisur detyrën papritmas dhe pa njoftim paraprak, pa komunikuar drejtpërdrejt me drejtuesin e prokurorisë dhe pa u dorëzuar asnjë dosje kolegëve të tij. Ky largim i bërë jashtë vendit, është deklaruar nga subjekti më pas, për të bërë një trajtim mjekësor për më shumë se 45 ditë. Duket sikur ky veprim i subjektit shkaktoi shumë vështirësi organizative për trajtimin e duhur të çështjes në gjykatë.

Për sa më sipër i është kërkuar subjektit të shpjegonte sjelljen e tij dhe ai ka kthyer përgjigje lidhur me këtë çështje⁵.

Për këtë çështje është ripyetur edhe një herë subjekti, duke dhënë shpjegime sipas përgjigjes të pyetësorit nr. 3⁶.

Në përgjigjet e *pyetësorit nr. 3*, subjekti i rivlerësimit i referohet faktit se largimi i tij nga Shqipëria në Itali për arsye shëndetësore ishte rezultat i një këshille të dhënë nga kirurgu urolog dr. R.Xh. Subjekti deklaroi se ishte i shokuar dhe se në përpjekje për të gjetur një klinikë jashtë vendit, njoftimi për Drejtuesin e Prokurorisë më 5 shtator 2018 nuk ishte në fokusin e tij. Megjithatë, pohoi se në mbrëmjen e po të njëjtës ditë ai la çelësin e zyrës, duke i treguar gjithashtu dosjen e çështjes oficerit të policisë gjyqësore, z. A.L. Më tej raportoi se të nesërmen u përpoq të kontaktonte me drejtuesin e prokurorisë, por pa sukses.

Komisioni është i mendimit se qëndrimi i subjektit, në fillim të shtatorit 2018, kur u largua nga vendi për një trajtim mjekësor në Itali, ka treguar një sjellje tepër joprofesionale. Bazuar në raportin e siguruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda – dhe shpjegimet e dhëna nga vetë subjekti – mund të konkludohet se pavarësisht kësaj ai ka gjetur kohën për të rezervuar një biletë për në Itali pranë një agjencie udhëtimi më 5 shtator 2018 dhe të informojë oficerin e policisë gjyqësore, por nuk ka informuar shefin e zyrës së tij derisa u kontaktua nga një punonjës i zyrës – më 6 shtator 2018, ku u ftua të merrte pjesë në një mbledhje për të bërë përgatitjet e duhura për një seancë dëgjimore në një rast të rëndësishëm dhe të ndjeshëm që ishte planifikuar brenda një afati të shkurtër. Meqenëse subjekti e dinte që do të ishte jashtë zyre për një kohë mjaft të gjatë, duhet të kishte qenë më profesional dhe duhet të kishte njoftuar shefin e zyrës në mënyrë më të përshtatshme.

Qasja e përgjithshme e subjektit në rastin “****”, në fakt, shprehet në fund të përgjigjeve që ka dhënë në *pyetësorin nr. 3*, ku deklaroi se largimi i tij për arsye shëndetësore ishte parashikuar në legjislacion si një “rast fator”, i cili nuk mund të parashikohej se kur do të ndodhte.”

Komisioni nuk ndan këtë qasje, pasi *rasti fator*, në përgjithësi, përcaktohet nga teoria e ligjit si një rrethanë me karakter individual dhe të jashtëzakonshëm, përtej kontrollit të palës dhe i pavarur nga vullneti i tij, i cili nuk mund të parandalohet ose eliminohet dhe pengon plotësisht ose pjesërisht zbatimin e detyrimeve ose të të drejtave. Është e qartë se ky nuk ishte rasti në lidhje me mundësitë e subjektit për të informuar shefin e zyrës, duke marrë parasysh rrethanat

⁵ Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

në fjalë. Për këtë subjektit iu kërkuan shpjegime në rezultatet e hetimit dhe subjekti i paraqiti ato⁷.

DENONCIMET

1. Denoncimi i z. V.Ç.

Komisioni, bazuar në këtë denoncim, ka konstatuar se subjekti gjatë veprimtarisë në funksionin e prokurorit në të kaluarën kishte filluar një procedim penal, pas një ankese të z. V. Ç., për korrupsion kundër disa gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit. Si arsye për mosfillimin e hetimit subjekti ka përmendur: *“Prokuroria nuk mund të hetojë gjyqtarët të cilët janë objekt denoncimi për vendimin e tyre në rastin kur denoncuesi është palë. Legjitimiteti i një vendimi gjyqësor është kompetenca e një gjykate më të lartë në sistemin gjyqësor”*.

Subjekti është pyetur nëse mund të shpjegonte arsyet e mosfillimit të hetimit ndaj këtyre gjyqtarëve, pasi denoncimi i bërë ka qenë për akuza korrupsioni dhe jo për vlerësimin e vendimmarrjes së tyre.

Për këtë çështje subjekti ka kthyer përgjigje duke deklaruar⁸: *“Shtetasi V.Ç., është një person i cili ka bërë shumë kallëzime ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë. Në rastin konkret, pavarësisht se emri i kallëzimit ishte për korrupsion, në asnjë element të kallëzimit nuk flitej për korrupsion, por për elemente dukshëm të vendimmarrjes së gjyqtarëve.*

Së dyti, kallëzimi nuk kishte elemente të veprës penale, por vetëm supozime të kallëzimitarit, të cilat e bënin kallëzimin të pabazuar në asnjë indice apo të dhëna serioze.

Së treti, rezulton se z. V.Ç., prej dy dekadash ka bërë rreth 200 kallëzime ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke pretenduar se në vijimësi i janë bërë padrejtësi”.

Komisioni konstatoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti për këtë çështje janë vetëm deklarata lidhur me statusin dhe gjendjen personale të denoncuesit dhe nuk janë shpjegime lidhur me denoncimin dhe me hetimin e kryer për veprime të kundërligjshme ose jo të subjekteve të denoncuar.

Komisioni dëshiron të vërë në dukje se, referuar denoncimit të paraqitur nga z. V.Ç., – në arsyetimin e vendimit që subjekti ka marrë në datën 26.12.2018, për mosfillimin e procedimit penal të regjistruar me nr. ***– është përdorur një gjuhë, e cila nuk rezulton të jetë në përputhje me urdhrin nr. ***, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregulloreve të etikës dhe të sjelljes së prokurorëve”, që përcakton parimet, të cilat urdhërojnë, ndër të tjera: *“Të respektojnë të drejtat e të gjithë personave për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe të shmangin diskriminimin e çdo personi për arsye, si: [...], shëndetësore apo të ndonjë statusi tjetër...[...] ...Në marrëdhënie me personat që i nënshtrohen procedimit penal, të tregojnë drejtësi, efikasitet, të respektojnë dinjitetin e personit, të drejtojnë hetimin në kërkim të së vërtetës...”*.

⁷ Shihni përgjigjen e rezultateve të hetimit të dërguara nga subjekti në dosjen e Komisionit

⁸ Shihni përgjigjen e rezultateve të hetimit të dërguara nga subjekti, në dosjen e Komisionit.

Përmendja e gjendjes mendore të mëparshme të denoncuesit duket e tepruar dhe duhej të mos ishte bërë nga subjekti në ato përmasa që u bë, vetëm me qëllimin për të justifikuar vendimin që ka dhënë më datë 26.12.2018.

Për këtë subjektit iu kërkuan shpjegime, të cilat subjekti i dha në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹.

2. Denoncimi i z. A. E.

Sipas dokumentacionit që disponohet në këtë proces rivlerësimi, Komisioni do të donte të kujtonte ekzistencën – lidhur me kallëzimet penale të bëra nga shtetasi A.E., – e dy hetimeve penale, njëri prej të cilëve nisi pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2018, e shfuqizoi vendimin e subjektit për mosfillimin e hetimit penal. Ndërsa procedimi i dytë penal (ai me nr. ***) është referuar se është nisur në bazë të pretendimeve të shtetasit A.E., pretendime të cilat u parashtruan në një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar¹⁰, lidhur me këtë kallëzim është vendosur mosfillimi i hetimeve: *“Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2018, çmoi se prokurori nuk mund të hetojë gjyqtarë apo prokurorë të kallëzuar për shkak të vendimmarrjes së tyre. Gjykata vendosi që kishte mundësi të hetohej për veprën penale “grup i strukturuar kriminal”, lidhur me përvetësimin dhe me shfrytëzimin me koncesion të hidrocentralit të Xhyrës, Librazhd, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Shtetasi A. E., nuk ka dy procedime penale ndaj meje, por vetëm një procedim”.*

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur te provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të vlerësimit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave privatë, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti e ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokuror.

⁹ Shihni përgjigjen e rezultateve të hetimit të dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁰ Shihni përgjigjen e rezultateve të hetimit të dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

B. Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. Për vlerësimin e aftësive profesionale

Lidhur me kriterin profesional trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe të provave të paraqitura nga subjekti dhe pas propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Por lidhur me disa çështje profesionale, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime, sipas rezultateve të hetimit Komisioni konstatoi se në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit 84/2016, këto çështje duhet të transferohen pranë organit kompetent për inspektim për shkelje të mundshme disiplinore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Çështjet të cilat duhet të transferohen për inspektim janë:

1. Dosja nr. 2 me objekt: “vendim për pushimin e procedimit penal”, nr. ***, datë 17.5.2013, nga pesë dosjet e përzgjedhura me short.
2. Kallëzimi penal i bërë nga kallëzuesja M.V., në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 4.11.2016, ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal.
3. Çështja që subjekti ka pasur në shqyrtim si prokuror, e gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me të pandehurit z. E.Sh., dhe të tjerë.
4. Procedimi penal i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në denoncimin e z. V. Ç., i cili akuzonte për korrupsion disa gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel minimal të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Ened Nakuçi, prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit 84/2016, transferimin në organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore, të cilat rezultuan nga gjetjet në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.
3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.6.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE

Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Roland ILIA

Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore